



5747
Nr. 23-03-22
Data

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 84/5 Prot.

Shkodër, më 17/03 /2022

LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

- **Vendimin nr.84/4 prot., datë 21.02.2022 për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor ndaj** debitorit, z.Rei Riza Shpuza, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal i identifikimi J60701093N, me adresë: Ali Demi, Nd.108, Njësia Administrative nr.1, Tiranë.

Për vazhdimin e procedurave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor është domosdoshmëri data e shpalljes publike.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETARE

Aida DEZDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS SHKODËR

Nr. 84/4 Prot.

Shkodër, më 21/02/2022

V E N D I M

Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor ndaj debitorit

Z. Rei Shpuza

I datëlindjes 01.07.1996,

Me numër personal identifikimi J60701093N

Dega e Doganës Shkodër me vendimin nr. 95, datë 28.09.2021 ka vendosur kontabilizimin dhe arkëtimin e borxhit doganor në shumën totale 3.803.942 lekë, për debitorin, **z.Rei Shpuza**, i datëlindjes 01.07.1996, me numër personal identifikimi J60701093N, me adresë: **Ali Demi, Nd.108, Njësia Administrative nr.1, Bashkia Tiranë**.

Ky vendim i është komunikuar debitorit të mësipërm, përmes njoftimit me postë rekomande me Lajmërim marrje RR 657 531 016 AA, për të cilin nuk ka marrë njoftim pasi zarfi është kthyer me shënimin "i panjohur".

Referuar të dhënave të dërguara nga Zyra e Gjendjes Civile me shkresën nr.9018/1 prot., datë 14.06.2021 (protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr.811/2 prot., datë 15.06.2021) të Bashkisë Shkodër, për shtetasin e sipërcituar, rezulton të jetë e njëjta adresë e dhënë.

Për një procedurë sa më korrekte administrative me shkresën nr.770/7 prot., datë 03.11.2021, i kemi ridërguar debitorit "z.Rei Shpuza" sipas adresës së marrë nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Platformës e – Albania, edhe një here, me postë rekomande, me Lajmërim marrje RR 651 023 713 AA vendimin administrativ nr.95, datë 28.09.2021, për të cilin nuk ka marrë njoftim pasi zarfi është kthyer me shënimin "objekt i pakërkuar".

Me shkresën nr.84 prot., datë 12.01.2022, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, referuar nenit 162 të ligjit nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë" Dega e Doganës Shkodër ka bërë kërkesë për shpallje publike të Vendimit administrativ nr.95, datë 28.09.2021 pranë Bashkisë Tiranë, Njesisë Administrative nr.1.

Me shkresën nr. 126/1 prot., datë 19.01.2022 (protokolluar pranë Degës së Doganës Shkodër me nr. 284/2 prot., datë 20.01.2022) Bashkia Tiranë, Njësia Administrative nr.1, na konfirmon se shpallja për z.Rei Shpuza është afishuar në këndin e njoftimeve me datën 17.01.2022 dhe njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 162, të ligjit të sipërcituar.

Me shkresën nr.84/1 prot., datë 18.01.2022, bazuar në nenin 162 të ligjit nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë” Dega e Doganës Shkodër ka bërë shpallje publike në këndin e njoftimeve të degës për vendimin e sipërcituar, i cili vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 162.

Me shkresën nr.84/3 prot., datë 09.02.2022 bazuar në nenin 96 të ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të ligjit nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Dega Doganës Shkodër ka kërkuar shpalljen në faqen e internetit të organit publik për vendimin e sipërcituar.

Me shkresën (ciklim) Nr.2634 prot., datë 11.02.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka bërë afishimin e shpalljes publike në këtë faqe sipas kërkesës <https://dogana.gov.al/dokument/3875/sh-2634-dt-11-02-2022> (e aksesueshme nga të gjithë).

Sa më sipër, pas zbatimit të të gjithë procedurave ligjore për njoftimin e debitorit, shtetasi z.Igins Rushiti nuk ka paraqitur ankim mbrenda këtyre afateve. Debitorit megjithëse i ka kaluar afati ligjor i ankimit dhe afati i ekzekutimit vullnetare, nuk ka likuiduar borxhin doganor të lindur sipas vendimit të sipërpërmendur.

Në këto kushte në bazë të vendimit sipërpërmendur të Degës Doganës Shkodër, me qëllim rikuperimin me forcë të borxhit doganor në shumën prej 3.803.942 lekë, për debitorin, z.Rei Shpuza me numër personal identifikimi J60701093N që ka ndaj Degës Doganës Shkodër, në zbatim të nenit 280 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 511 e vijues të K.Pr.C., dhe udhëzimit Nr.15 datë 03.12.2018 të Drejtorisë Përgjithshme Doganave “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”.

VENDOSA QË :

1. Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë sendet me vlerë të çmuar, valutë të huaj të depozituara në bankë, që i përkasin debitorit, **z.Rei Shpuza, me numër personal identifikimi J60701093N** personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
2. Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme dhe të patundshme që i përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit .
3. Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet e mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme të përcaktuar në **vendimin nr. 95, datë 28.09.2021** të Degës së Doganës Shkodër, **si dhe të kamatë vonesave të lindura** në bazë të nenit 245 pika 1/b të Kodit Doganor deri në ditën e likuidimit të borxhit doganor.

KRYETAR

Aida DIZDARI

